



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE
VLORE

Nr.Regj.Them 2037
Dt.Regj 27.11.2015

Nr. 14. Vendimi
Datë 14.01.2016

V E N D I M

“Në emër të Republikës”

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore, e përbërë prej :

Gjyqtar- Astrit Shema

asistuar prej sekretares gjyqesore Anila Rista, në Vlore, sot më datë 14.01.2016 përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqesore publike çështjen civile me Nr. 2037. Regj.Them, date paraqitje 27.11.2015, që i përket paleve ndergjyqese :

PADITES : Altin Molishti, i biri i Musa-it, i datelindjes 03.04.1979, person fizik me NIPT- L 52804002 L, me seli ne lagjen 22 Tetori, Blv. Republika, Berat. Tel: 069 62 95 581, I perfaqesuar ne gjykim me procure te posacme nga ana e av.Alban Syri, dhoma e avokatise Berat me nr.lic.5252, (ne mungese ne shpallje vendimi).

TE PADITUR : 1. Drejtoria Rajonale Tatimore, Berat. Rruga Anpitatrea, Berat, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim te dates 17.12.2015 me nr.6565/3.Prot nga an e jursites se ketij institucioni zj.Silvana Sallo, (ne mungese ne shpallje vendimi).

2. Drejtoria e Apelimit Tatimor, prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, Rruga Gjirin Bue Shpata, Tirane, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim te dates 10.12.2015 me nr.40491/1.Prot nga ana e juristes se Drejtorise Rajonale Tatimore, Berat zj.Silvana Sallo, (ne mungese ne shpallje vendimi).

OBJEKTI: 1.Shfuqizimin e aktit administrate, Njofitim Vleresimit Per detyrimet Tatimore, nr.4229/42 prot, date 10.09.2015, te Drejtorise Rajonale Tatimore Berat.


2.Shfuqizimin e vendimit nr. 29206/1 prot, date 26.10.2015 te Drejtorise se Apelimit Tatimor, Tirane.

Baza Ligjore : Ligji nr.49/2012 Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative, ligji nr.8485, date 12.5.1999 K.Pr.Administrative, ligji nr.9920, date 19.05.2008 Per Procedurat Tatimore dhe Udhezimi i Ministrit te Financave nr.24, date 02.09.2008.

Gjykata pasi mori provat e nevojeshme, degjoi ne kerkimet perfundimtare palet ne proces te cilat u shprehen respektivisht :

Paditësi (nepermjet avokatit te zgjedhur prej tij) kërkoj: Pranimin e padisë,

R



RR 140 076 552 AA

Perfaqesuesia e paleve te paditura : Rrezimin e padise;
si e analizoi çeshtjen ne teresine e saj :

VEREN:

Paditesi i është drejtuar kesaj gjykate, me padine e mesipercituar me objekt gjykimi te mesipercituar.

Gjykata, pasi studioi materialet e çështjes civile me Nr.2037.Akti , date 27.11.2015.Rregji te paraqitur per gjykim, ne baze te nenit 36 te K.Pr.Civile, ne te cilin parashikohet shprehimisht se: "Ne juridiksionin e Gjykatave hyjne te gjitha mosmarreveshjet civile dhe mosmarreveshje te tjera te parashikuara ne kete Kod e ne ligje te veçanta" si dhe ne reference dhe te nenit 7 te ligjit me nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" ne te cilin citohet se : " Gjykatat administrative janë kompetente për:

a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;duke qene se ndodhemi perpara nje mosmarreveshje me karakter administrativ qe rrjedh nga marredheniet civile mes paleve ndergjyqese", çmoi kryesisht se çështja e paraqitur eshte ne kompetencen lendore te kesaj gjykate.

Gjithashtu ne reference te nenit 10 te ligjit te mesipercituar "Kompetenca funksionale" ne te cilin citohet se : " 1. Gjykata administrative e shkallës së parë shqyrton mosmarrëveshjet administrative të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, me përjashtim të atyre që lidhen me aktin nënligjor normative,arriti ne kunkludimin se kjo çeshtje eshte nen kompetencen funksionale te kesaj gjykate.

Ne lidhje me kompetence tokesore kjo gjykate j'u referuar nejit 11 te ligjit me nr. 49/20012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" ne te cilin citohet se "1. Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet. Në rastet kur organi administrativ më i lartë, pas ankimit administrativ, e ndryshon aktin administrativ të organit vartës, padija ngrihet në gjykatën që përfshin territorin ku ka qendër organi administrativ më i lartë.

Gjithashtu Gjykata, në vështirim të neneve 12 te ligjit te mesipercituar, çmoi çeshtje duhet gjykuar me nje gjyqtar te vetem.

Rrethanat e çështjes.

Me njoftim vleresimin nr.4229/24 prot, date 10.09.2015, Drejtoria Rajonale Tatimore Berat i ka kerkuar ankuesit pagimin e detyrimit tatimor te perbere nga : *Gjoke nemasen 50.000 leke, per mos instalim paisje fiskale.* Ndaj ketij njoftim vleresimi ankuesi ka bere ankim prane Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane, e cila me vendimin e saj nr.29206/1 date 26.10.2015 ka vendosur:

- Lenien ne fuqi te Njoftim Vleresimit nr.4229/24 prot, date 10.09.2015, per gjoben ne masen 50.000 Leke, per mospajisje me kase fiskale" nxjerre nga DRT Berat.

Ky vendim i eshte komunikuar paditesit nepermjetpostes me date 28.10.2015. Ne vendimin e saj nr.29206/1 date 26.10.2015 DAP Tirane, nder te tjera arsyeton :

... Me date 07.09.2015 nga inspektoret e Verifikimit ne Terren ne DRT Berat, eshte ushtruar kontroll tek tatimpaguesi dhe ne perfiindim eshte perpiluar Akt konstatimi me nr.0537451, date 07.09.2015, ku thuhet: *ne zbatim te urdherit te punes nr.4130/10prot, date 07.09.2015, nxjerre nga DRT Berat per kontroll ne subjketin Altin Molishti : subjekti nuk ka te instaluar kasen fiskale, por ka aplikuar ne daten 02.09.2015, prane shqerise BNT Elektronik per paisje me kase fiskale "*

Bazuar ne kete Akt-Konstatimi eshte penalizuar tatimpaguesi me gjobe ne shumen 50.000 Leke nga DRT Berat, bazuar ne nenin 122, pika a, germa i, te ligjit nr.9920, date 19.05.2008, i ndryshuar duke nxjerre edhe aktin administrativ, Njoftim Vleresimi nr.4229/24 prot, date 10.09.2015 per Mosinstalim te paisjes fiskale.

Tatimpaguesi kerkon anulimin e gjebes sipas Njoftim Vleresimit nr.4229/24 prot, date 10.09.2015 duke pretenduar se : *Subjekti eshte regjistruar prane QKR-se me date 04.04.2015, por subjekti nuk ka filluar aktivitetin sepse me pas eshte bere adoptimi i ambientit per tu pershtatur sipas nevojës se aktivitetit. Me date 02.09.2015 kemi bere aplikim per paisje me kase fiskale. "*

Lidhur me pretendimet dhe informacionin e tatimpaguesit, Drejtoria e Apelimit Tatimore vlereson se nuk mund te merret ne konsiderate sepse nuk jane zbatuar afatet ligjore per paisjen dhe instalimit te paisjeve fiskale sipas kerkesave te pikes 15 te VKM nr.781, date 14.11.2007 ... ¹.... *tatimpaguesi e ka patur detyrim ligjor te instaloje paisjen fiskale, me afat kohor deri ne 15 dite pune nga dita qe ka filluar aktivitetin, ku sipas Ekstraktit tefaqes zyrtare te QKR-se vleresohet qe aktivitetin e ka filluar me date 04.04.2015, sikurse pretendon edhe tatimpaguesi-pranmdaj dhe ka vendosur me ane te vendimit te saj me nr.29208/1.Prot,date 26.10.2015 : Lenien ne fuqi te aktit administrativ : Njoftim-vleresimi me nr.4229/24.Prot,date 10.09.2015 te gjebes ne masen prej 50.000 leke per "Mospajisje me kase fiskale" nxjerre nga ana e DRT Berat per subjektin "Altin Molishti"-Berat.*

Ne rrethana te tilla pala paditese ka ushtruar te drejten e ankimit gjyqesor prane Gjykates Administrative duke pretenduar sipas aj persa me poshte vijon :

Pretendimet e pales paditese.

Aktet administrative te te paditurve vijne ne kundërshtim me ligjin dhe cenojne interesat e paditesit personi fizik Altin Molishti dhe duhet te shfuqizohen nga gjykata pasi:

- Ne referim te pikes 122 te udhezimit nr.24 date 02.09.2008 te Ministrise se Financave, organet tatimore denojne tatimpaguesin me gjobe ne rast se nuk ka instaluar paisjen fiskale **"heren e pare te konstatimit"** te mos instalimit te paisjes fiskale, per te cilin eshte percaktuar nje afat vendosje deri ne 10 dite, nderkohe qe ligji e ka zgjatur afatin ne 15 dite.

Inspektoret e anes se paditur duke aplikuar gjoben per mos instalimin e kases nuk lene permblusur letyrimet e percaktuara ne kete nen, pasi ata nuk i kane percaktuar me pare ndonje nje afat ankuesit per instalimin e paisjes fiskale dhe pas ketij afati, ne rast konstatimi te mungeses se kases ta denonin me gjobe.

Arsyetimi i anes se paditur se kasa duhej te ishte instaluar qe ne momentin e pare pas regjistrimit ne QKR me date 04.04.2015, nuk gjen asnje mbështetje ligjore edhe ne nenet e vete cituara nga ana e paditur, erkundrazi ky arsyetim eshte rrezuar nga gjykata, ne rastet te ngjashme.

Te fagen ueb te Drejtorise se Pergjithsme te Tatimeve per qellime informuese eshte botuar edhe vendimi nr. 93, date: 03.03.2015 i Gjykates Administrative te Apelit Tirane ne te cilin nder te tjera theksohet:

Ne interpretim te permbajtjes se kesaj dispozite te posacme duket qarte se organi tatimor ne rastin e pare konstatimit te mosinstalimit te paisjes fiskale per pilon procesverbalin e konstatimit te mosinstalimit te paisjes skale, mban Procesverbalin e Konstatimit me subjektin inspektues ku i vendos nje afat 10 ditor per instalimin e paisjes fiskale, ne te kundert ne rastin e mosvendosjes se paisjes brenda afatit te caktuar nga rji prej 10 dite ateherë si rezultat i ketij mosveprimi ky veprim konsiderohet si veprim i kundraligjshem, i li perben kundravajtje administrative dhe rrjedhimisht penalizohet. ... ligji nr.9920, date 19.05.2008 Per procedurat Tatimore ne R.Sh, te ndryshuar, ndryshe nga sa pretendon i padituri, normon dhe vendos ne afat likim penaliteti dhe nuk penalizon subjektin per shkak te afatit 10 ditor te regjistrimit si subjekt privat o te kalimit te afatit 10 ditor te percaktuar ne vendosjen e paisjes fiskale nga subjektet, por e penalizon

kur kerkon afati i vendosur nga organi tatimor per vendosjen e paisjes fiskale. Per pasoje ligjvenesit pavarësisht te mosrespektimit te detyrimit ligjor per vendosje e paisjes fiskale, nga subjekti i ka normuar detyrimin qe organi tatimor para se te aplikojë penalizimin duhet te caktojë afatin 10 ditore per vendosjen e paisjes fiskale, i cili ne rastin konkret nuk eshte zbatuar prej inspektorëve te. pales se paditur e per rrjedhoje me te drejte gjykata e shkalles se pare ka arritur ne perfundimin se akti eshte absolutisht i pavlefshem.

Aktualisht DAT Tirane pasi ka konstatuar zbatimin e gabuar te ligjit ne lidhje me gjobitjen e subjekteve per mos pajisje me kase fiskale ne vendimet e saj te fundit ka ndryshuar qendrim dhe ka ndryshuar qendrim duke arsyetuar ne nje rast te ngjashem se : Ne aktin e konstatimit inspektorët shprehën se tatimpaguesi ka aplikuar per marrjen e pajisjes fiskale ne daten 09.09.2015, çka vertehet dhe nga dokumentacioni bashkëlikosur kerkëses ankimore. Gjithashtu , referuar dokumentacionit konfirmohet se tatimpaguesi e ka kryer pagesen e pajisjes fiskale disa dite perpara kryerjes se kontrollit nga administrata tatimore. Nese tatimpaguesi ka aplikuar per paisjen fiskale, vleresohet se qellimi i tij eshte dokumentimi i shitjeve ne perputhje me legjislacionin tatimor. Pra ne te tilla raste, pergjithesisht administrata tatimore ka gjykuar se tatimpaguesi eshte vene ne levizje per t'u paisur me kase fiskale me deshiren e tij, pa u diktuar nje veprim i tille nga organet tatimore. ... denimi ne rastet kur tatimpaguesi ka aplikuar per paisjen fiskale do te binte ndesh me qellimin e ligjit, pasi tatimpaguesi ka qene i interesuar per paisjen fiskale perpara momentit te kontrollit dhe perpara marrjes se masave administrative.

Ne rastin konkret ndaj tatimpaguesit nuk jane respektuar dispozitat ligjore nga punonjesit e administrates tatimore qe do te kishte sjelle si rezultat mosnxjerrjen e ketij njoftim vleresimi, nderkohe qe nuk ka kundravajtje pasi subjekti kishte aplikuar per paisjen me kase fiskale ne date 02.09.2015. Persa me siper kerkojme pranimin e padise sipas objekti te saj.

Prapësimet e pales se paditur.

Vlersimi tatimor eshte rrjedhoje e penalizimit, si rezultat i kontrollit te ushtruar ne subjektin Altin Molishti nga inspektorët e Drejtorise Rajonale Tatimore Berat, ne baze te urdherit te punes nr.4130/10 prot.date 07.09.2015.

Nga kontrolli i ushtruar ne subjektin Altin Molishti eshte mbajtur Akt-Konstatimi nr.0537152, dhe ne baze te Akt-Konstatimit eshte mbajtur dhe Proces-Verbali i gjobes nr.0182174 date 07.09.2015, duke e penalizuar subjektin me gjobe ne vleren 50 000 leke per mosinstalim te paisjes fiskale, bazuar ne nenin 122,pika 1 germa a/ii te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH" i ndryshuar.

Ne vijim te procedures eshte nxjerre akti administrative, Njoftim Vlersimi Nr. 4229/42 date 10.09.2015, qe ka penalizuar shoqerin me gjobe ne vleren 50 000 leke.

Gjoha e nxjerre nga ky Njoftim-vlersim ne vleren 50000 leke ,per mosinstalim te paisjes fiskale, eshte i bazuar ne ligjin Nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperis", i ndryshuar ,dhe me konkretisht ne nenin 122 pika 1 germa a-i, (dhe akteve nenligjore ne zbatim te tij) ku percaktohet se : 122.1 Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, denohet ne rast se: a) nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme te monitorimit te qarkullimit: i) heren e pare te konstatimit te mosinstalimit te pajisjes fiskale ose sistemeve te monitorimit te qarkullimit, me gjobe ne masen 50 000 (pesedhjetë mijë) leke;

Per tatimpaguesit e regjistruar per here te pare ose qe plotesojne per here te pare detyrimin ligjor per instalimin e pajisjes fiskale ose sistemit te monitorimit te qarkullimit aplikohet nje afat prej 15 ditesh pune per vendosjen dhe instalimin e pajisjes fiskale apo sistemit te monitorimit te qarkullimit;

Ne akt - konstatim nder te tjera shprehet se: "Subjekti nuk ka te instaluar paisjen fiskale por ka aplikuar ne daten 02.09.2015 prane shoqerise BNT Elektornikper pajisje me kase fiskale".

Fakti qe subjekti ka aplikuar per pajisje fiskale nuk e shmang ate nga penaliteti i gjobes, per faktin se subjekti

nuk e kishte te instaluar paisjen fiskale ne momentin e kontrollit si dhe subjekti nuk ka respektuar afatet ligjore per paisjen dhe instalimin me pajisje fikale.

Subjekti eshte regjistruar ne QKR, me date 04.04.2015, dhe ne baze te ligjit per procedurat tatimore subjkti ka detyrimin ligjor te paiset me paisje fiskale brenda 15 diteve nga data e regjistrimit, gje e cila nuk eshte bere nga ana e subjektit dhe ne momentin e ushtrimit te kontrollit subjekti nuk e kishte te instaluar paisjen fiskale, dhe nuk e kishte bere aplikimin per kase benda afateve ligjore.

Vendimi i Keshillit te Ministrave Nr. 781, date 14.11.2007, ne lidhje me regjistrimin e qarkullimit, percakton se: " *Te gjitha tatimpaguesit e shitjeve pakice, qe shesin mallra apo ofrojne sherbime ne mjedise, apo njesi te perhershme te hapura me publikun, instalojne paisje fiskale dhe leshojne kupone tatimore per cdo transakcion* "

Per sa eshte parashikuar me larte pala paditese ka ushtruar aktivitetin tregetar e saj tregetar, ne kundershtrim me percaktimet e ligjit nr.9920/2008 si dhe akteve nenligjore ne fuqi, duke mosperdorur kasen fiskale konforme kushteve dhe rregullave te perdorimit ne kryerjen e veprimeve tregetare.

Persa eshte cituar me lart, si dhe referuar Ligjit nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" (i ndryshuar) ne nenet e siperpermendura, Udhhezimit Nr.24 date 02.09.2008 ne zbatim te ligjit, Kreu VI, pika 55 si dhe VKM-se Nr.781, date 14.11.2007, i ndryshuar, eshte e percaktuar qarte gjoba per mosinstalim te paisjes fiskale.

Ne piken 80.03 c) te Udhhezimit nr.24, date 02.09.2008, ne zbatim te ligjit eshte percaktuar se:

"Verifikimet ne vend,

Keto verifikime te shkurtra synojne zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje me regjistrimin e personave te tatueshem (identifikimin e personave te paregjistruar), me perdorimin e pajisjeve fiskale, me perdorimin e pullave fiskale ne mallrat e akcizes, me dokumentimin e mallrave ne ruajtje, perdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe leshimin faturave tatimore, etj. Keto verifikime kryhen pa njoftimin paraprak te personave te tatueshem, por vetem nepermjet prezantimit ne momentin e verifikimit, te dokumentit personal te verifikuesit dhe urdhrin e dites, te leshuar nga drejtuesi i drejtorise se kontrollit per verifikime ne vend"

Per sa me siper, aktet administrative Njoftim Vlersimi per Detyrimet Tatimore nr.2643 date 11.06.2015 i DRT Berat, dhe Vendimi Nr.21935/2 date 08.10.2015, te Drejtorise se Apelimet Tatimor Tirane, jane te mbeshtetur ne ligj, si dhe mbeshtetur ne Legjislacionet e siperpermendura, ne nenin 331/1 te Kodit te Procedures Civile dhe nenin 40 pika 3 te Ligjit me nr.49 date 03.05.2012, "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykateve Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreshjeve Administrative"

Nga Gjykata Administrative e Shkalle se Pare Vlore, kerkojme :Rrezimin e Kerkese Padise te ngritur nga paditesi, subjekti Altin Molishti dhe lenien ne fuqi te akteve tona administrative.

Legjislacioni i zbatueshem.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 42 të saj, parashikon se:

"Kushdo për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj".

Ky parashikim kushtetues është në të njëjtën linjë me neni 6 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore:

"Cdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarreshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e cdo akuze të natyrës penale që i është drejtuar".

Ndërkohë, gjykatat detyrohen edhe nga neni 44 i Kushtetutës, sipas të cilit:

"Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.

Për sa më sipër, vendimi objekt shqyrtimi do të trajtohet nga gjykata si cdo akt administrativ. Në nenin 15 të ligjit me nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet, se: Te drejten e padisë e ka: a) cdo subject, qe pretendon se i është cenuar nje e drejte apo nje interes i ligjshem nga nje veprim apo mosveprim i organit public;

"Padia, sipas nenit 17 të këtij Ligji mund të ngrihet kur paditësi argumenton se akti administrativ është i paligjshëm dhe se atij i cënohen interesat dhe të drejtat e tij në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, individualisht ose në mënyrë kolektive..."

-Ligji me nr.9920,date 19.05.2008"Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" i9 ndryshuar.

- Kodi I Procedures Administrative te Republikes se Shqiperise.

-Udhezimi nr. 24 date 02.09.2008, "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar; VKM nr.781,date 14.11.2007 si dhe ligji nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmareveshjeve Administrative".

Zgjidhja ligjore.

Gjykata ne lidhje me barren e proves per te provuar ligjshmerine e veprimeve apo mosveprimeve te organit administrativ, ka per reference nenin 35/1 te ligjit me nr. nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" ne te cilin citohet se :"*Organi i administrates publike ka detyrimin te provoje ligjshmerine e aktit administrativ, kontrates administrative dhe te veprimit tjeter administrativ te nxjerre jo me kerkese te paditesit si dhe te faktit qe ka parashtruar dhe ka vene ne themel te veprimtarise se kundërshtuar ne gjykate*".

Gjithashtu, Gjykata, duke vlerësuar në tërësi rrethanat faktike të provuara në gjykim nëpërmjet provave shkresore, thëniet dhe pohimet e palëve ndërgjyqëse, të çmuara në përputhje me nenet 10,11,12, 29, 213, 214, 246 e vijues dhe 253 e vijues të K.Pr.C dhe mbështetjen ligjore të padisë, si dhe duke referuar në hapësirën ligjore që krijon neni 16 i KPrC sipas të cilit "Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen pa u lidhur me përcaktimet që mund të propozojnë palët.", arrin në konkluzionin se padia duhet rrezua, për arsyet si më poshtë vijon:

Subjekti Altin Molishti me nr. Nipt L52804002L, është regjistruar ne Drejtorine Rajonale Tatimore Berat me aktivitet privat "Tregtia me pakice e pijeve ne dyqane te specializuara", me adrese te aktivitetit ne lagjen "22 Tetori" Berat. Subjekti i është drejtuar Gjykares Administrative te Shkalles se Pare Vlore me objekt padije "Shfuqizimin e akteve administrative " ne lidhje me njoftim vlersimin nr. 4229/42 date 10.09.2015.

Me ane te Njoftim Vlersimit nr. 4229/42 date 10.09.2015 derguar nga DRT Berat, subjektit i është komunikuar penaliteti ne vlere 50 000 leke per mospaisje me kase fiskale, bazuar ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i nryshuar, neni 122 pika 1 germa a,i.

Pala paditese e ka ankimuar aktin administrative per detyrimet tatimore Njoftim Vlersimit nr. 4229/42 date 10.09.2015, ne Drejtorine e Apelimit Tatimor Tirane, e cila me vendimin nr. 29206/1 date 26.10.2015 (prot me DRT Berat me nr.4229/27 date 29.10.2015) ka vendosur: "Lenien ne fuqi te aktit administrative Njoftim Vlersimin per detyrimet tatimore nr. 4229/42 date 10.09.2015te

nxjerre nga DRT Berat".

Ne rrethana te tilla pala paditese ka ushtruar te drejten e ankimit gjyqesor prane Gjykates Administrative duke pretenduar sipas aj persa me poshte vijon :

- Inspektoret tatimore nuk kane respektuar afin kohor qe duhet t'i vendosnin tetimpaguesit per vendosjen e kases fiskale m/q,se eshte here e pare e konsttaimit qe nuk ishte vendosur kjo kase.

- Arsyetimi i apes se paditur se kasa duhej te ishte instaluar qe ne momentin e pare pas regjistrimit ne QKR ne date 04.04.2015, nuk gjen asnje mbeshtetje ligjore edhe ne nenet e vete cituara nga ana e paditur, perkundrazi ky arsyetim eshte rrezuar nga gjykata, ne rastet te ngjashme.

- Aktualisht DAT Tirane pasi ka konstatuar zbatimin e gabuar te ligjit ne lidhje me gjobitjen e subjekteve per mos pajisje me kase fiskale ne vendimet e saj te fundit ka ndryshuar qendrim dhe ka ndryshuar qendrim.

Gjykata konstaton se me date 07.09.2015 nga inspektore te Verifimit ne Terren ne DRT Berat, eshte ushtruar kontroll tek tatimpaguesi dhe ne perfundim eshte perpiluar Akt konstatimi me nr. 0537451, date 07.09.2015, ku thuhet se: "...Ne zbatim te urdherit te punes nr. 4130/10 prot, date 07.09.2015, nxjerre nga DRTBerat, per kontroll ne subjektin Altin Malishti: ...subjekti nuk ka te instaluar kasen fiskale, por ka aplikuar ne daten 02.09.2015, prane shoqerise BNT Elektronik per pajisje me kase fiskale.. ". Bazuar ne kete Akt-konstatim, eshte penalizuar tatimpaguesi me gjobe ne shumen 50.000 leke nga DRT Berat, bazuar ne Nenin 122, pika "a", germa "i" te Ligjit Nr. 9920 date 19.05.2008, i ndryshuar, duke nxjerre edhe aktin administrativ, Njoftim Vleresimi nr. 4229/24 prot, date 10.09.2015, per "Mosinstalim te pajisjes fiskale".

Tatimpaguesi kerkon anullimin e gjobes sipas Njoftim Vleresimit nr. 4229/24 prot, date 10.09.2015, duke pretenduar se: "... Subjekti eshte rregjistruar parane QKR-se Berat me date 04.04.2015, por subjekti nuk ka filluar aktivitetin sepse me pas eshte bere adoptimi i ambientit poer tu pershtatur sipas nevojës se aktivitetit...Me date 02.09.2015 kemi bere aplikim per tupajisur me kase fiskale..."

Lidhur me pretendimet dhe informacionin e tatimpaguesit, Drejtoria e Apelimit Tatimor, vlereson se nuk mund te merret ne konsiderate sepse nuk jane zbatuar afatet ligjore per afatet e pajisjes dhe instalimit te pajisjeve fiskale sipas kerkesave te pikes 15 "Procedura e instalimit te pajisjes fiskale" e VKM Nr. 781, date 14.11.2007, ku percaktohet: *"15.1 Tatimpaguesi aplikon per pajisje apo sistem fiskal prane shoqerije te autorizuar. Shoqerite e autorizuar jane te detyruara te pajisin tatimpaguesin me sistem apo pajisje fiskale brenda 15 diteve nga nenshkrimi i kontrates. Shoqerite e autorizuar kryejne regjistrimin e te dhenave themeltare sipas pikes 8.1.2 te ketij vendimx"*. Ne rastin konkret tatimpaguesi nuk ka aplikuar ne kohe prane shoqerise se autorizuar, per te instaluar pajisjet fiskale elektronike.

Detyrimi i tatimpaguesit per te instaluar pajisjet fiskale buron nga:

Neni 55, "Detyrimi per perdorimin e pajisjeve fiskale", i Ligjit Nr. 9920, date 19.05.2008, "Per Procedurat Tatimore ne RSH", i ndryshuar, percaktohet se:

1. Tatimpaguesit qe kryejne qarkullimin e mallrave dhe sherbimeve per te cilat pagesat nuk kryhen nepermjet bankes, jane te detyruar te fusin dhe te perdorin sistemin fiskal, nepermjet perdorimit te pajisjeve fiskale, per regjistrimin e pagesave me para ne dore dhe per leshimin, ne menyre te detyrueshme, te kuponit tatimor.

Gjithashtu ne Udhезimin e M.F. Nr. 24, date 02.09.2008, pika 55. "Detyrimi per perdorimin e Pajisjeve fiskale", percaktohet se:

"Personat e tatueshem, subjekte te tatimit mbi vleren e shtuar apo te tatimit mbifitimin dhe personal e tatueshem, tatimpagues i tatimit te thjeshtuar mbifitimin e biznesit te vogel" jane te detyruar te pajisen, te

perdorin dhe mirembajne pajisjet fiskale ne perputhje me dispozitat e Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 781, date 14.11.2007 "Per karakteristikat teknike e funksionale te pajisjeve fiskale, sistemit te integruar te kompjuterizuar per transferimet periodike, automatike te deklarimeve financiare, sistemit te komunikimit per proceduren e dokumentacionin per miratimin e tyre dhe per kriteret per pajisjen me autorizim te shoqerive te autorizuar per ofrimin e pajisjeve fiskale" dhe akteve te tjera nenligjore ne zbatim te tij".

Bazuar ne percaktimet ligjore e nenligjore te sipercituara, dhe referuar nenit 122, pika 1, germa "a, i" te ligji Nr. 9920, date 19.05.2008, ku percaktohet se: " Per tatimpaguesit e regjistruar per here te pare ose qe plotesojne per here te pare detyrimin ligjor per instalimin e pajisjes fiskale ose sistemit te monitorimit te qarkullimit aplikohet nje afat prej 15 ditesh pune per vendosjen dhe instalimin e pajisjes fiskale apo sistemit te monitorimit te qarkullimit-, tatimpaguesi e ka patur detyrim ligjor te instaloje pajisjes fiskale, me afat kohor deri ne 15 dite pune nga dita qe ka filluar aktivitetin, ku sipas Ekstraktit Historik te faqes zyrtare te QKR-se vleresohet qe aktivitetin e ka filluar me date 04.04.2015, si? pretendon edhe tatimpaguesi.

Ne Ligjin Nr. 9920, date 19.05.2008, "Per Profedurat Tatimore ne RSH",i ndryshuar, neni 122, "Kundervajtjet administrative ne perdorimin e pajisjeve fiskale, per leshimin e kuponave fiskale e te biletave" pika 1, germa a, percaktohet se:

1. "Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, denohet ne rast se: a) nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme te monitorimit te qarkullimit: i) heren e pare te konstatimit te mosinstalimit tepajisjes fiskale ose sistemeve te monitorimit te qarkullimit, me gjobe ne masen 50 000 (pesedhete mije) leke.

Gjykata vlereson se veprimet e pales se paditur jane ne perputhje me Ligjin Nr.9920, date 19.5.2008 "Per Progedurat Tatimore ne R.Sh-se " nenet 106,107,108, pika 3, germa "a, i" dhe Udhezimin e Ministrit Financave, nr. 24 date 02.09.2008 , pika 108.3.3, ne zbatim te ligjit,prandaj nuk konstaton ndonje shkak ligjor per shfuqizimin e akteve administrative objekt ankimi.

Sa me siper, gjykata krijoi bindjen se kërkesa padia e paditësit është e pa mbështetur në ligj dhe ne prova dhe, si rrjedhojë e ajo duhet rrezuar.

Meqenese kjo padi u rrezua nga ana e Gjykates atehere, ne mbeshtetje te nenit 106 te K.Pr.Civile taksa mbi aktet,shpenzimet e tjera gjyqesore dhe per nje avokat i ngarkohen inicuese te ktij gjykimi/paditese.

Vlen te theksohet se ku vendim ne mbeshtetje te nenit 45 te ligjit nr.49/2012 « Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative » duke qene se ndodhemi perpara faktit te kundershimit te nje akti administrativ ku vlere e mases se kundershuar ne kete akt administrativ eshte me e vogel se njezetfishi i pages minimale ne shkalle vendi,vendimi i mesipercituar eshte i paankimueshem.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata,bazuar ne nenin 126 dhe 310 te K.Pr.Civile dhe nenet 40, 42 te ligjit me nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative":

VENDOSI:

Rrezimin e kërkesë padisë.

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës inicuese te ktij gjykimi..

Ky vendim eshte i formes se prere konform nenit 45 te ligjit nr.49/2012 « Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative ».

U shpall në Vlore, sot më dt. 14.01.2016

SEKRETARE
Anila Rista



GJYQTARI
Astrit Shema

